



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy

Analizë

Zhvillimi i TIK-ut në shkolla

Komuna e Podujevës

2022

Ky publikim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Ministrisë së Ekonomisë. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e OJQ-së Sundimi i Demokracisë në Kosovë dhe jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e Ministrisë së Ekonomisë.

Përmbajtja

Hyrje	4
Informacione të përgjithshme mbi zhvillimin e Teknologjisë Informative në Kosovë.....	5
Dokumentet Strategjike për zhvillim të TIK në Kosovë.....	6
Tregu i Punës në TIK.....	7
TIK në Arsim	8
TIK-u në Shkolla.....	10
- Kompjuteri	11
- USB	11
- Interneti	11
- Tabela Interaktive	11
- Video Projektori	11
Paisja e Shkollave të Komunës së Podujevës me TIK.....	12
- Furnizimi me internet	13
- Paisja me kabinet të informatikës.....	14
- Furnizimi me paisje tjera teknologjike.....	14
Përfundimi	15
Rekomandime	16

Hyrje

Shoqëria e bazuar në dituri nevojitet që të posedojë aftësi të mira komunikuese dhe sociale, të jetë e mirë informuar dhe të jetë gjithmonë e gatshme të mësojë gjëra të reja. Për t'u bërë pjesëtar të kësaj shoqërie qytetarët duhet të marrin pjese në mënyrë aktive në këtë shoqëri dhe ti ndjejnë benifitet e ofruara nga ajo. Atyre duhet t'ju jepet mundësia që ti kenë dhe arrijnë ato dituri dhe aftësi të nevojshme. Ato gjithashtu duhet që në mënyrë kreative t'i arrijnë dituritë dhe eksperiencat duke krijuar zgjidhje origjinale për problemet.

Në kohën bashkëkohore ndikimi i teknologjisë informatike dhe të komunikimit (TIK) gjithnjë e më shumë bëhet i gjithëpërfshires në shumë sfera shoqërore. Ky zbatim nuk e anashkalon as arsimin. Arsimimi dhe dituria janë baza e çdo zhvillimi njerëzor dhe ato janë e drejta fundamentale për çdo qenie njerëzore. Dominimi i metodave tradicionale të cilat e fuqizojnë njohurinë enciklopedike dhe jo specifike apo praktike, mungesa e mësimdhënies interaktive dhe inovacioneve bëjnë që teknologjia informatike e komunikimit të shfrytëzohet si reformator për ti plotësuar kërkesat globale për mësimdhënie sa më pragmatike dhe për ti ndjekur trendet bashkëkohore arsimore ku nxënësi vendoset në qendër të vëmendjes dhe ku amplifikohet të menduarit kritik dhe zgjedhja e problemeve.

Nevoja dhe arsyeja e aplikimit të TIK-ut në arsim niset nga fakti i përgatitjes së të rinjve për tu bërë liderë dhe të suksesshëm në këtë shoqëri të udhëhequr nga informacionet. Aftësitë e komunikimit, procesimit, mendimit kritik dhe zgjedhjes së problemeve si dhe puna në grupe janë esenciale në shoqërinë teknologjike dhe socioekonomike të shekullit 21. Arsimimi në këtë mjedis të sofistikuar do të bëjë më shumë se vetëm lexim, shkrim apo përvetësim të shkathtësive aritmetike. Duhet të ofrojë edhe shkathtësi pune që do ti ndihmonin të rinjtë ta arrijnë potencialin e tyre njerëzor. Zhvillimi i shoqërisë informatike paraqet një nga detyrat prioritare të të gjitha qeverive botërore. Nuk ka dyshim se arsimimi është njëri nga segmentet kryesore në nxitjen dhe përkrahjen e zhvillimit të shoqërisë informatike, edhe atë në dy aspekte. Pikë së pari, ky segment duhet të jetë promotor i shoqërisë informatike dhe të inicojë krijimin e kuadrove profesionale dhe kompetente të cilët mund tju përgjigjen sfidave të shoqërisë informatike dhe nevojave të ekonomisë së bazuar në dituri. Së dyti, cilësia e procesit edukativo arsimor në mënyrë të drejtë mvaret nga zbatimi i teknologjisë informatike dhe komunikimit në po atë proces.

TIK-u është duke u bë thelbi i përgatitjes së studentëve për pjesëmarrje të suksesshme në ekonominë e dijes dhe shoqërinë e të mësuarit. Gjithashtu, duke pasur parasysh rolin e tyre në transformimin aktual të ekonomive të përparuara, teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) ofrojnë premtimin e biznesit të ri dhe mundësi punësimi, së bashku me përfitime më të larta produktiviteti, por gjithashtu bëjnë kërkesa të reja për shkathtësi.¹

¹ Kozma, R. (n.d.). National Policies that Connect ICT Based Education Reform to Economic and Social Development. [\(PDF\) National Policies that Connect ICT-Based Education Reform to Economic and Social Development \(researchgate.net\)](#)

Andaj në këtë punim është paraqitur një përmbledhje e zhvillimit të TIK-ut në Kosovë duke u nisur nga përshkrimi i dokumenteve strategjike që prioritetizojnë fushën e TIK-ut; tregun e punës në TIK dhe njëkohësisht duke i kushtuar një vëmendje të veçantë mundësisë së zhvillimit të kësaj fushe përmes sistemit arsimor në Kosovë, duke pasur në fokus komunën e Podujevës.

Informacione të përgjithshme mbi zhvillimin e Teknologjisë Informative në Kosovë

Teknologjia në Kosovë hasi vështirësi të shumta përgjatë zhvillimit të saj. Teknologjia në Kosovë u zhvillua diçka më shumë me hapa të shpejtë pas vitit 1999 (Pas mbarimit të luftës). Ky zhvillim vazhdon akoma edhe në ditët e sotme. Disa nga degët që u zhvilluan pas luftës, janë: Teknologjia e Informimit, 3D Printimi, Programimi, etj. Organizata dhe kompani të ndryshme kontribuan dhe akoma vazhdojnë kontribojnë në zhvillimet e këtyre teknologjive.

Transformimi teknologjik që e ka përfshirë botën brenda dekadave të kaluara, i ka dhënë rrugë lindjes së shumë bizneseve të TIK, qëllimi kryesor i të cilave është ofrimi i produkteve dhe shërbimeve teknologjike që i ndihmojnë aktivitetet e përditshme të bizneseve, u ofrojnë klientëve shërbim të avancuar, dhe ndër të tjera, e bëjnë jetën e njerëzve më të lehtë. Për më tepër, rritja dhe zhvillimi i një numri të madh të bizneseve që organizojnë punën dixhitale sot ka sjellë ndryshime të mëdha në tregun e punës, sikurse në shkallë ndërkombëtare, ashtu edhe në shkallë vendore në Kosovë.² Kjo ka bërë që e gjithë shoqëria të kalojë në një kthesë tjetër e cila lidh secilin profesion me aplikimin e teknologjisë

Tre treguesit bazë që ofrojnë një pasqyrë të përgjithshme të nivelit aktual të gatishmërisë së përgjithshme dixhitale për një ekonomi specifike janë: niveli i përdorimit të internetit, niveli i qasjes në internet në familje dhe niveli i aftësive të përgjithshme dixhitale. Sipas të dhënave zyrtare të Eurostat, përqindja e individëve që kanë përdorur internetin të paktën një herë në 12 muaj në Kosovë ishte 91% në vitin 2019, duke u rritur në mënyrë të vazhdueshme nga 88% në 2018 dhe 86% në 2017. Kjo përqindje është më e larta në mesin e vendeve perëndimore. Të dhënat e Eurostat-it tregojnë gjithashtu se përqindja e familjeve me qasje në internet në Kosovë ishte 93% në vitin 2019, e cila sërish renditet si më e larta në mesin e ekonomive të Ballkanit Perëndimor. Këta dy tregues të përmendur të kombinuar sugjerojnë se ekziston një bazë shumë solide për veprime shtesë në fushën e zhvillimit të dixhitalizimit në Kosovë.³

Nga ana tjetër, sipas të dhënave zyrtare të Eurostat-it, niveli i aftësive digjitale për individët në Kosovë është i ulët në krahasim me ekonomitë e tjera në Ballkanin Perëndimor dhe shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të dhënat brenda kësaj fushe janë relativisht të dobëta dhe mund të gjenden vetëm për vitet 2017 dhe 2019. Duke parë përqindjen e individëve me aftësi bazë ose mbi aftësitë bazë digjitale, Kosova renditet e dyta më e ulëta në mesin e ekonomive të

² The Future Workplace [OPEN-DATA-Report_alb_preview.pdf](#)

³ DIGITAL SKILLS NEEDS AND GAPS IN THE ĒESTERN BALKANS [Digital skills_final.pdf](#)

Ballkanit Perëndimor – kishte 28% e individëve brenda kësaj kategorie në vitin 2019, që paraqet një rritje nga 21% në vitin 2017. Krahasisht, mesatarja e BE-së ishte 57%. Përqindja e atyre me aftësi bazë dixhitale është vendi ku Kosova renditet më e ulëta në mesin e ekonomive të Ballkanit Perëndimor me 13% në vitin 2019. Përqindja e individëve me aftësi bazë dixhitale është mesatarisht për ekonomitë e Ballkanit Perëndimor – 14% e individëve në Kosovë i përkiste kësaj kategorie në vitin 2019. Individët e klasifikuar si me aftësi të ulëta dixhitale përbënin 59% në vitin 2019, krahasuar me mesataren e BE-së prej 29%, dhe kjo është përqindja më e lartë në mesin e Ballkanit Perëndimor.⁴

Raporti Analitik i Barometrit Ballkanik mbi Opinionet Publike 2020 gjen ndërgjegjësim në rritje për dixhitalizimin potencial nga një numër në rritje i banorëve të rajonit. Ndërsa ende relativisht modest, numri i të anketuarve që ndjekin trajnime në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit është rritur në mënyrë të qëndrueshme. Në Kosovë, 24% e përdorin internetin për arsim. Shumica e temave të zakonshme të trajnimit në teknologjinë e informacionit janë përdorimi i kompjuterit, softueri ose aplikacionet, dhe të mësuarit rreth mediave sociale ose analizës së të dhënave. Metoda më e shpeshtë e të mësuarit është online dhe vetë-studimi, me më pak trajnime të ofruara në vendin e punës. Raporti i Opinionit të Biznesit të Barometrit Ballkanik 2020 thekson se punësimi dhe arsimi janë fusha, rëndësia e të cilave do të rritet gjatë periudhës së ardhshme. Raporti thekson se pothuajse 80% e menaxherëve në rajoni thekson se aftësitë dixhitale janë thelbësore për të kryer bizneset e tyre. Gjithashtu, vlerësohet se prodhimi i universiteteve është i pamjaftueshëm për sa i përket cilësisë dhe sasisë⁵.

Kompanitë e TI-së duhet të investojnë në masë të madhe në të diplomuarit universitarë sepse profili i tyre i aftësive nuk përputhet me kërkesat e tregut. Ekziston një mospërputhje mes planprogrameve dhe kërkesave të kompanive. Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, çka i jep kësaj ekonomie një potencial të shkëlqyer zhvillimi, sipas analizave të Bankës Botërore

Dokumentet Strategjike për zhvillim të TIK në Kosovë

Programi për Reforma në Ekonomi 2022-2024 përfshinë disa fusha prioritare të reformës strukturore: edukimi dhe aftësitë, zhvillimin e inovacionin, transformimin digjital, punësimin dhe tregun e punës. Reforma prioritare e arsimit dhe aftësive synon të rrisë arsimin dhe aftësimin profesional bazuar në kërkesat e tregut të punës duke zhvilluar standarde të reja profesionale dhe duke rishikuar kurrikulat bazuar në dialogun e sektorit të biznesit. Aftësitë dixhitale nuk janë një pjesë specifike e këtij dokumenti, por me sa duket janë të përfshira në përkufizimin e përgjithshëm të "aftësive". Masa e përshkruar e Transformimit digjital në këtë

⁴ DIGITAL SKILLS NEEDS AND GAPS IN THE ĚESTERN BALKANS [Digital skills_final.pdf](#)

⁵ Poaty

dokument është: *“Shtrirja e infrastruktures dhe shërbimeve të TIK-ut për zhvillim socio-ekonomik, shërbime publike të avancuara si dhe digjitalizim të sistemit arsimor”*⁶.

Strategjia e TI-së e Kosovës 2022-2027 është një dokument thelbësor i përbërë nga shtylla strategjike. Kjo Strategji u konceptua në të njëjtën kohë si një udhërrëfyes strategjik dhe udhërrëfyes. Vizioni i saj është që të “promovojë transformimin dixhital dhe të mbështesë Kosovën që të bëhet një ekonomi e bazuar në dije”. Fokusi i strategjisë së TI-së në Kosovë është në softuerin dhe shërbimin e TI-së.

Shtylla 5 e kësaj Strategjie i dedikohet përmirësimit të arsimit të TI-së dhe promovimit të përsosmërisë së BNj në Kosovë. Kjo shtyllë strategjike është e orientuar drejt nxitjes së arsimit dhe burimeve njerëzore duke përmirësuar vazhdimisht arsimin e TI-së në Kosovë* në arsimin fillor, të mesëm dhe të mesëm dhe kryesisht nivelet terciare. Shtylla gjithashtu parashikon se “Theks i veçantë duhet t’i kushtohet përafrimin e kurrikulave të TI-së me nevojat specifike të sektorit privat dhe nxitjes së bashkëpunimit të ngushtë midis universiteteve dhe industrisë së IT-së”.

Në kuadër të Strategjisë Zhvillimore Kombëtare 2030, një ndër prioritetet është edhe Agjenda Digjitale. Qeveria e Kosovës si pjesë të kornizës së saj strategjike ka hartuar një dokument të veçantë të quajtur Agjenda Digjitale e Kosovës 2030. Agjenda digjitale është një dokument ndër-sektorial i cili përcakton politikat dhe prioritetet në kontekst të transformimit të vazhdueshëm digjital të ekonomisë dhe shoqërisë të ndikuara nga teknologjitë inovative dhe trendet globale digjitale. Përmes Agjendës Digjitale 2030, Kosova do të shfrytëzojë zhvillimin e mundësive të teknologjive të avancuara të informimit dhe komunikimit për tu bërë ekonomi dhe shoqëri digjitale dhe për të mbështetur rritjen ekonomike dhe konkurrueshmërinë.⁷

Që nga viti 2018, Kosova ka në fuqi një Strategji Kombëtare për Inovacion dhe Ndërmarrësi (2019-2023) me vizionin që ekonomia të bazojë konkurrencën e saj ekonomike në përdorimin efektiv të njohurive, kreativitetit dhe inovacionit, të njihet ndërkombëtarisht si qendër e orientuar drejt digjitalizimit dhe rajonal për inovacionin dhe kërkimin shkencor me efekte ekonomike dhe të bëhet qendër e zhvillimit rajonal të ekonomisë dixhitale.⁸

Tregu i Punës në TIK

Tregu i punës së TIK-ut përballet me sfida të ndryshme. Së pari, ka mungesë të fuqisë së aftë punëtore për të përmbushur kërkesat e biznesit. Kjo çon në biznese që nuk punojnë me potencial të plotë për të ofruar produkte dhe shërbime të kërkuara nga klientët e tyre. Së dyti, bizneset nuk pësojnë rritje të planifikuar si rezultat i mungesës së burimeve të nevojshme njerëzore. Për më tepër, kjo çon në paga më të larta që duhet t’u paguhen individëve që posedojnë aftësi të tilla të kërkuara, duke paraqitur kështu pengesë financiare për biznesin. Së

⁶ PROGRAMI PËR REFORMA NË EKONOMI (PRE) 2022-2024 <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41299>

⁷ Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41413>

⁸ Strategji Kombëtare për Inovacion dhe Ndërmarrësi (2019-2023) <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40551>

tretej, ekziston mungesë e rrjedhës së vazhdueshme midis ofertës së tregut të punës dhe kërkesës, duke rezultuar që potenciali i TIK të humbet.⁹

Në kuadër të një hulumtimi rreth punësimit të rinjve, është organizuar një fokusgruyp me përfaqësues të sektorit privat dhe përgjigjet nga ky sektor ishin të ndryshme sipas industrive. Kompanitë private të cilat ofrojnë pozicionet që kërkojnë kualifikime të larta, përkatësisht teknologjinë e komunikimit (TIK) informacion, kanë deklaruar se ata shpesh i konsiderojnë të rinjtë si zgjedhjen e tyre të parë të punësimit, pavarësisht mungesës së përvojës, pasi që ata tregojnë më shumë interes në këto pozita, dhe mund të përshtatet lehtë me kulturën e kompanisë. Fakti që të rinjtë nuk kanë kualifikimin e nevojshëm, për disa nga kompanitë që mund të konsiderohen më të ngritura nuk është një pengesë në punësimin e tyre, pasi ato janë mësuar me konceptin e investimit në zhvillimin profesional të stafit të tyre. Një nga pikat në të cilat të gjithë përfaqësuesit e sektorit privat në fokus grupin tonë që të gjithë kanë rënë dakord është se rinia është burimi më i mirë i fuqisë punëtore për bizneset pasi që ata janë të motivuar dhe të gatshëm për të mësuar, duke e bërë më të lehtë të përshtaten me kulturën e punës dhe ata mësojnë lehtë.¹⁰

OECD thekson se si në pjesët e tjera të Evropës, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe sipërmarrësit janë shtytësit kryesorë të rritjes gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, krijimit të vendeve të punës, zhvillimit të aftësive dhe inovacionit për Ballkanin Perëndimor. Zhvillimi i një sektori dinamik dhe konkurrues të NVM-ve është bërë edhe më prioritet për Kosovën në procesin e saj të integritimit në BE. OECD vëren se Kosova ka bërë përparim të mirë në mbështetjen e NVM-ve në ekonominë digjitale. Programi i Reformës Ekonomike 2019-2021 pasqyron rëndësinë e NVM-ve në ekonominë dixhitale dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik po kërkon të zbatojë një projekt për të zgjeruar aksesin dhe përdorimin e TIK-ut. Një model pozitiv ka qenë diapazoni i gjerë i trajnimeve mbi aftësitë dixhitale të vënë në dispozicion të NVM-ve, duke përfshirë trajnimin online, kostot e të cilave mbulohen pjesërisht nga Ministria e Inovacionit dhe Sipërmarrjes.¹¹

TIK në Arsim

Përdorimi i TIK–ut në të gjitha proceset jetësore është kthyer në një domosdoshmëri jetike në mbarë botën. Poashtu integrimi i TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënie është një domosdoshmëri e kohës në të cilën po jetojmë.

⁹ The Future Workplace [OPEN-DATA-Report_alb_preview.pdf](#)

¹⁰ RAPORTI PËR PAPUNËSINË E TË RINJVE NË KOSOVË <http://www.ngolens.org/wp-content/uploads/2018/04/papunesia.pdf>

¹¹ www.rcc.int/pubs/95/report-on-the-preparation-of-post-2020-strategy-in-the-eastern-balkans

Roli tradicional i TIK-ut ka qenë ai i një lënde të vogël kurrikulare, e quajtur ndonjëherë informatikë ose mësim i kompjuterit. Megjithatë, në disa vende, TIK tani është në qendër të përpjekjeve të reformës arsimore që përfshijnë përdorimin e saj në koordinim me ndryshimet në kurrikulë.

Vendet si Singapori (Ministria e Arsimit, Singapor) deri te Kili (Ministerio de Educación, Republika de Chile) Shtetet e Bashkuara (Departamenti i Arsimit i SH.B.A.) Norvegji (Ministria e Arsimit, Hulumtimit dhe Çështjeve të Kishës, Norvegji) kanë marrë qëndrim që integrimi i TIK-ut në klasa dhe kurrikula mund të përmirësojë sistemet arsimore dhe t'i përgatisë studentët për kreativitet të teknologjisë. Në mënyrë të ngjashme, organizatat shumëkombëshe, të tilla si Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) Komisioni Evropian, dhe vendet e G8 e kanë identifikuar nevojën për t'i përgatitur studentët për mësimin gjatë gjithë jetës në ekonominë e dijes dhe ato i caktojnë një rol qendror TIK-ut në përmbushjen e këtij qëllimi¹²

Këto studime tregojnë se ndryshime të rëndësishme janë duke ndodhur në përdorimin e TIK-ut në shkolla. Në vendin tonë shumë dokumente strategjike siç janë edhe të cekura më lartë, shihet se prioritetizohet aftësimi në fushën e teknologjisë, por institucionet arsimore ende nuk ofrojnë arsimim i cili përshtatet me kërkesën e tregut. Nxënësve/studentëve u mungojnë mjetet dhe metodat e nevojshme për të marrë vendim të informuar për studimet e tyre të mundshme në fushën e TIK-ut, me fjalë të tjera, shkollat e mesme dhe universitetet kanë mungesë të qasjes të drejtuar nga të dhënat për krijimin e një mësimi të azhurnuar që nxit zhvillimin e një fuqie punëtore që i përgjigjet kërkesave të biznesit dhe institucioneve.


Përdorimi i TIK-ut duhet të shihet si një mjet që i ndihmon nxënësit të përqëndrohen më gjatë në klasë, pasi informacioni mund të transmetohet në forma të ndryshme audio-vizive (eksperimentet virtuale, filmat dokumentarë, prezantimet PowerPoint, posterat, leximi i historive online, ritregimi i një historie duke e rishkruar në Word, ndarja e informacioneve me shkollat e tjera nëpërmjet e-mail-it).

TIK-u është një formë e veçantë e veprimtarisë krijuese, ku njerëzit ndërveprojnë me mjediset e tyre duke përdorur materialet, inputet dhe proceset e duhura në përgjigje të nevojave, dëshirave dhe mundësive të tyre. Ai integron shprehitë për zgjidhjen e problemeve dhe ato praktike në prodhimin e produkteve dhe të sistemeve të dobishme. Për këtë arsye ai është i pranishëm në shumë fusha të të nxënës, por veçanërisht në fushën e shkencave natyrore¹³

¹² Anyaegbunam, F. N. C. (2013, October). ICT and Educational Reform ([PDF](#)) [ICT and Educational Reform. \(researchgate.net\)](#)

¹³ UDHËZUES KURRIKULAR LËNDOR PËR TIK-un [Material ndihmës për mësuesit e TIK-ut në arsimin e mesëm të ulët.pdf](#)

Në figurën më posht shohim një ilustrim se si lidhja e TIK-ut me fushat e tjera pasuron situatat e mësimi, në të cilat nxënësit zhvillojnë kompetencat e tij.



Marrë nga: UDHËZUES KURRIKULAR LËNDOR PËR TIK-un [Material ndihmës për mësuesit e TIK-ut në arsimin e mesëm të ulët.pdf](#)

TIK-u në Shkollë

Një përmbledhje bashkëkohore e literaturës që ka të bëjë me studime nga praktika të suksesshme dhe politika arsimore ilustron progres të rëndësishëm në Evropë, përfshirjen e TIK-ut në mësimdhënie.

TIK në shkollë kuptohet si një implementim i pajisjeve dhe mjeteve teknologjike në procesin mësimor për të regjistruar dhe përpunuar informacionin në formë digjitale. Përdorimi i teknologjisë në shkollat tona ka ndryshuar në mënyrë të ndjeshme këto vitet e fundit. Kështu, për të pajisur nxënësit me aftësitë e nevojshme teknologjike, duhet të përdorim metoda të reja të të mësuarit në krahasim me metodat e përdorura në të mësuarit tradicional.

Teknologjia dhe mjetet teknologjike janë bërë pjesë e edukimit në shkolla dhe synimi është të përdorim teknologjinë në klasa si një mjet që zhvillon dhe nxit më tej procesin e të mësuarit. Nxënësit, nga përdorimi i këtyre mjeteve të reja teknologjike kanë përfituar aftësi kompjuterike, aftësi të cilat do të mund t'i përdorin në të ardhmen në vendet e tyre të punës. Shkollat në sistemin arsimor shqiptar kanë krijuar një infrastrukturë teknologjike, e cila optimizon integrimin e teknologjisë në procesin edukativ. Përdorimi me efikasitet i teknologjive të reja që mbështet procesin e të menduarit të nxënësit, rrit aftësinë e nxënësit për t'u përqendruar në mësim, përmirëson të kuptuarit dhe transferon përmbajtjen në një memorje afatgjatë. Duke u mbështetur në këtë arsyetim, është synuar t'i kthejmë klasat tradicionale në klasa të konceptuara mbi bazën e teknologjisë. Ky proces kërkon që mësuesit të pajisen me aftësitë e duhura teknologjike dhe të mësojnë të përdorin mjetet e reja teknologjike që mbështesin procesin e mësimdhënies të nxënësit dhe progresin e tyre. Ja disa nga teknologjitë që mësimdhënësit duhet të përdorin:

- Kompjuteri

Shihet si një nga teknologjitë më të nevojshme në fushën e mësimdhënies, deri para pak kohësh ai konsiderohej si një risi, tashmë ai është i domosdoshëm për shkak të orientimeve teknologjike që kanë përfshirë mësimdhënien.

- USB

Është njëra nga teknologjitë më të përparuara përse i përket ruajtjes dhe transmetimit të informacioneve të ndryshme, ato ekzistojnë në madhësi të ndryshme dhe janë pjesë e pandashme tashmë e realitetit arsimor.

- Interneti

Është teknologjia e cila ka revolucionizuar mësimdhënien në çdo skaj të botës. Me anën e tij, tashmë mësuesi nuk është e vetmja pikë e referimit, por është koordinatori i hyrjeve të reja në kulturën arsimore të nxënësit.

- Tabela Interaktive

Është një teknologji mjaft e përparuar e cila ende nuk është futur në masë në sistemin arsimor shqiptar, por ama për shkak të thjeshtësive, risive dhe avantazheve që ajo paraqet, është mjaft e dëshiruar në dobi të punës së tij (saj) nga çdo mësimdhënës.

- Video Projektori

Është një teknologji e cila gjendet mjaft në sistemin arsimor shqiptar. Me anën e tij realizohet prezantimi i punimeve të ndryshme në fushën didaktike dhe shkencore. Në të vërtetë ai është

paraardhës i tabelës interaktive, por ama për vetë kushtet e sistemit tonë arsimor ai ngelet si teknologjia

Paisja e Shkollave të Komunës së Podujevës me TIK

Pajisja e shkollave me TIK dhe internet është zakonisht hapi i parë në agjendën e hartuesve të politikave. Vendosja e kompjuterëve mund të bëhet në mënyra të ndryshme, duke i vendosur në kabinete të informatikës deri te klasat me një dhe shumë kompjuterë.

Në këtë kontekst SDK, ka bërë një hulumtim në shkollat e komunës së Podujevës për të parë se sa janë të pajisura me mjete për të ofruar mundësinë e zhvillimit të TIK-ut. Ky hulumtim është bërë duke adresuar një kërkesë tek Drejtorati Komunal i Arsimit për të marrë të dhëna se sa prej shkollave kanë qasje në internet, të pajisuara me kabinete të informatikës, me projektor, laptop dhe pajisje tjera teknologjike. Nga DKA kemi marrë përgjigje gjatë muajit Janar të vitit 2023, me të gjitha të dhënat e kërkuara.

Më posht po paraqesim tabelën për secilën shkollë se sa janë të pajisura me mjete të TIK-ut

Tabela nr. 1. Shkollat e Komunës së Podujevës dhe paisja me TIK

Nr. rend	Emri shkollës	Niveli	Vendi	Furnizim me internet	Pajisja me Kabinet të informatikës	Paisje tjera teknologjike
1	Aleksander Xhuvani	E mesme e Lartë	Podujevë	PO	Pjeserisht	Disa laptop
2	Isa Boletini	E mesme e Lartë	Podujevë	PO	Pjeserisht	Disa laptop
3	Fan S Noli	E mesme e Lartë	Podujevë	PO	Pjeserisht	Disa laptop
4	Shaban Shala	E mesme e Ulët	Podujevë	PO	PO	Disa laptop
5	Naim Frashëri	E mesme e Ulët	Podujevë	PO	Pjeserisht	Disa laptop
6	Dr. Ibrahim Rugova	E mesme e Ulët	Podujevë	PO	Pjeserisht	Disa laptop
7	Enver Maloku	E mesme e Ulët	Podujevë	PO	JO	Disa laptop
8	Ali Ajeti	E mesme e Ulët	Sfeqël	JO	JO	Disa laptop
9	Kongresi Manastirit	E mesme e Ulët	Gllamnik	JO	JO	Disa laptop
10	Luigj Gurakuqi	E mesme e Ulët	Batllavë	JO	JO	Disa laptop
11	Xheladin Rekaliu	E mesme e Ulët	Podujevë	JO	JO	Disa laptop
12	Ali Hadri	E mesme e Ulët	Obrançë	JO	JO	Disa laptop
13	Afrim Fahriu	E mesme e Ulët	Lluzhan	JO	JO	Disa laptop
14	Hyzriu e Samiu	E mesme e Ulët	Letanc	JO	JO	Disa laptop
15	Hamit Sejdiu	E mesme e Ulët	Këpirmeh	JO	Pjeserisht	Disa laptop
16	Ilir Konushevc	E mesme e Ulët	Lluga	JO	JO	Disa laptop
17	Dëshmorët e Kombit	E mesme e Ulët	Podujevë	JO	JO	Disa laptop
18	Shefki Kuleta	E mesme e Ulët	Tërnavë	JO	JO	Disa laptop
19	Nuhi Gashi	E mesme e Ulët	Bradash	JO	JO	Disa laptop
20	Zenel Hajdini	E mesme e Ulët	Lupq i Poshtëm	JO	JO	Disa laptop
21	Emin Duraku	E mesme e Ulët	Bajçincë	JO	JO	Disa laptop
22	Naum Veqilharxhi	E mesme e Ulët	Llapashticë e Eperme	JO	Pjeserisht	Disa laptop


23	Kadri Kadriu	E mesme e Ulët	Llaushë e Eperme	JO	JO	Disa laptop
24	Pavresia	E mesme e Ulët	Sibofc	JO	JO	Disa laptop
25	Sheqe Mirofci	E mesme e Ulët	Shtedim	JO	JO	Disa laptop
26	Drita	E mesme e Ulët	Majac	JO	JO	Disa laptop
27	Esad Mekuli	E mesme e Ulët	Dobratin	JO	JO	JO
28	Hasan Ramadani	E mesme e Ulët	Shajkoc	JO	JO	JO
29	Ditura	E mesme e Ulët	Llapashticë e Poshtme	JO	JO	Disa laptop
30	Lasgush Poradeci	E mesme e Ulët	Dumnicë	JO	JO	Disa laptop
31	Musli Dumoshi	E mesme e Ulët	Dumosh	JO	JO	JO
32	Eçrem Çabej	E mesme e Ulët	Buricë	JO	JO	Disa laptop
33	Zahir Pajaziti	E mesme e Ulët	Orllan	JO	JO	Disa laptop
34	Jetullah Gashi	E mesme e Ulët	Doberdol	JO	JO	JO
35	Elfir Behrami	E mesme e Ulët	Metehi	JO	JO	Disa laptop
36	Shefki Latifi	E mesme e Ulët	Pollatë	JO	JO	JO
37	Rilindja	E mesme e Ulët	Hërticë	JO	JO	JO
38	Jetullah Islami	E mesme e Ulët	Dyz	JO	JO	JO
39	Jahë Hasani	E mesme e Ulët	Bërvenik	JO	JO	JO
40	Sami Frashëri	E mesme e Ulët	Zhiti	JO	JO	JO

Siç shihet nga tabela, Komuna e Podujevës posedon gjithsej 3 shkolla të nivelit e mesme e lartë dhe 37 e mesme e ulët. Poasht shihet që edhe paisja e tyre me mjete teknologjike është jo e kënaqshme.

- Furnizimi me internet

U cekë edhe më lart se furnizimi me internet është një prej parakushteve që ofron mundësinë e zhvillimit të TIK-ut në shkolla/edukim

Grafikoni nr 1.




Në këtë drejtim shkollat e komunës së Podujevës nuk qëndrojnë në nivelin e kënaqshëm. Janë vetem 7 shkolla të furnizuara me internet, prej tyre janë 3 shkollat e nivelit të mesëm i lartë dhe vetem 4 prej tyre të nivelit i mesëm i ulët. Dhe poashtu shihet që vetem shkollat të cilat janë në qytetin e Podujevës

janë të furnizuara me internet, dhe asnjë prej shkollave që janë në vendet rurale nuk është e furnizuar me internet.

- Paisja me kabinet të informatikës

Kabineti informatikës shihet si një nga format më të nevojshme për t'i ofruar nxënësve mundësitë e zhvillimit të aftësive në këtë fushë. Mirpo komuna e podujevës nuk qëndron edhe mirë në këtë drejtim.

Grafikoni nr. 2




Siç shihet nga grafikoni është vetëm një shkollë që ofron këtë mundësi me kapacitetet të plotë dhe 7 prej tyre janë pjesërisht të pajisura, përderi sa 32 prej tyre nuk janë fare të pajisura.

- Furnizimi me paisje tjera teknologjike

Nëse i referohemi se sa shkollat e komunës së podujevës janë të pajisura me çfardo pajise tjeter teknologjike, shohim se shumica prej tyre janë të pajisur sëpaku me nga një laptop, për deri sa me projektor nuk është epaisur asnjë shkollë dhe dhe në anën tjetër shihet se janë 9 shkolla që nuk janë fare të paisura me ndonjë pajisje teknologjike

Grafikoni nr. 3



Përfundimi

Zhvillimi i teknologjisë paraqet një nga detyrat prioritare të të gjitha qeverive botërore. Nuk ka dyshim se arsimimi është njëri nga segmentet kryesore në nxitjen dhe përkrahjen e zhvillimit të teknologjisë, edhe atë në dy aspekte. Pikë së pari, ky segment duhet të jetë promotor i zhvillimit teknologjik dhe të inicojë krijimin e kuadrove profesionale dhe kompetentë të cilët mund të ju përgjigjen sfidave të shoqërisë në teknologji dhe nevojave të ekonomisë së bazuar në dituri. Së dyti, cilësia e procesit edukativo arsimor në mënyrë të drejtëpërdrejtë varet nga zbatimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në po atë proces. Në një botë që sa vjen e më shumë po orientohet drejt teknologjisë dhe globalizmit, kuptimi, përdorimi dhe krijimi i kulturës së Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit është bërë një faktor shumë i rëndësishëm që mundëson arsimimin e nxënësëve me edukim më bashkëkohor, e aftësi për tu përballur me sfidat e zhvillimit. TIK ka përmirësuar procesin e të mësuarit nëpërmjet ofrimit të materialeve interaktive, edukative që rrisin motivimin tek nxënësit dhe lehtësojnë marrjen e aftësive bazë. Përdorimi i paisjeve multimediale të ndryshme, të tilla si televizor, video dhe aplikacionet kompjuterike ofrojnë një ambient më sfidues dhe angazhim më të madh për të gjithë nxënësit. Shekulli XXI thekson nevojën e zhvendosjes së metodave të të mësuarit nga ajo e koncentruar te mësuesi në metoda të koncentruara te nxënësi, duke i dhënë një fleksibilitet të theksuar për çasjen në materialet e ndryshme. Shfytëzimi i teknologjisë në mënyrë efektive do të thotë që nxënësit të mësojnë më mirë dhe më shpejtë, nga ajo që kishin mësuar me mjetet e zakonshme. Përdorimi i teknologjisë me zotësi mundëson arritjen dhe plotësimin e qëllimeve mësimore për kohë më të shkurtër dhe më pak punë për mësuesit dhe nxënësit. Të mësuarit aktiv dhe bashkëpunues në mjedise të dixhitalizuara kontribuojnë jo vetëm në zhvillimin e dijeve të studentëve por edhe të menaxhuesit dhe administruesit të shkollave.

Në vendet e zhvilluara dhe elitave urbane të ekonomive të zhvilluara, shekulli XXI ka sjell integrimin e teknologjisë në edukim, në angazhimin e nxënësëve në mënyra që s'janë paramenduar më parë, zgjerimi i të arriturave dhe interaktivitetin me komunitetin lokal dhe global. Nxënësit jetojnë në një botë me shpërthim informacioni si dhe ndryshime të shpejta dhe të mëdha sociale dhe ekonomike. Në vendet në zhvillim, TIK përdoret për rritjen e qasjes në informacion dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit. TIK ofron shpejtësi të madhe në disponueshmërinë e informacionit të përgjithshëm dhe të rëndësishëm poashtu edhe në përfshirjen e grupeve të ndryshme të nxënësëve si të atyre me aftësi të kufizuara apo me probleme shëndetsore. Disponueshmëria e infrastrukturës së përshtatshme për mbështetjen e vendosjes së TIK-ut në shkolla është një sfidë e madhe me të cilën ballafaqohen aktualisht shkollat në vend. Kostoja e lartë fillestare e blerjes dhe implementimit të infrastrukturës së nevojshme, kostot e mirëmbajtjes, mbështetjes dhe përmirësimit janë pengesa për përdorimin e suksesshëm të TIK në shkolla

Rekomandime

Rekomandimet kryesore në kuadër të këtij punimi, i adresohen nivelit komunal, për faktin se siç u pa nga kjo analizë, komuna e Podujevës do duhej të i përkushtohet më shumë fushës së TIK-ut në shkollat e teritorit të saj.

Komuna e Podujevës gjegjësisht Drejtoria Komunale e Arsimit do të duhej të planifikoj një ndarje buxhetore që mundëson:

- Furnizimin me internet të të gjitha shkollave në teritorin e saj
- Furnizimin me kabinete të informatikës për shkollat në zonat rurale
- Furnizimin e shkollave me laptop dhe projektor
- Investimin në hapjen e një Qendre të Inovacionit, ku i'u mundësohet të rinjve që t'i zhvilojnë më tej aftësitë e tyre në fushën e TIK-ut

Rekomandime për shkollat

- Të gjithë nxënësit të edukohen në shkolla për edukimin e përdorimit të TIK-ut për qëllime të mësimt.
- Mësimdhënësit t'i udhëzojnë nxënësit që të sigurojnë informacion për temën që kanë në planin dhe në programin e tyre mësimor, duke përdorur Teknologjinë e Komunikimit dhe Informacionit
- Në shkollat e arsimit të obliguar të ekzistojë një lëndë e veçantë mësimore për edukimin e nxënësve për përdorimin e TIK-ut për qëllime pedagogjike, sepse nxënësit duhet të pajisen me aftësi dhe dije ideale për të qenë në dobi të vendit.